



FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë Shpallje për vend të lirë pune

| | |
|---|--|
| Pozita: | Zyrtar i Teknologjisë Informative |
| Organizata/njësia: | Shërbimet e Përgjithshme - FKEE |
| Lokacioni: | Prishtinë, Republika e Kosovës |
| Data e shpalljes së konkursit: | 21.11.2022 |
| Data/ora e mbylljes: | 05.12.2022 16:00 (koha lokale) |
| Lloji dhe kohëzgjatja e kontratës: | Kontratë pune me orar të plotë për një periudhë të caktuar kohore (3 vjet), me mundësi vazhdimi |
| Periudha provuese: | 3 muaj |
| Kur pritet të fillojë marrëdhënia e punës: | Brenda dy javësh pas nënshkrimit të kontratës së punës dhe jo më vonë se 01.01.2023 (cilado datë të jetë e para) |

A) Rrethanat organizative

Me miratimin e Ligjit Nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë (LEE), Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) është themeluar si entitet i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm, në mbështetje të objektivave të politikës për Eficiencë të Energjisë së Republikës së Kosovës, duke promovuar, mbështetur dhe zbatuar masat e eficiencës së energjisë, si dhe duke tërhequr dhe menaxhuar burimet financiare në mënyrë që të financojë dhe zbatojë projekte investimesh në fushën e Eficiencës së Energjisë në një mënyrë të qëndrueshme.

Zyrtar i Teknologjisë Informative punësohet nga Drejtori Menaxhues i FKEE-së për një mandat tre (3) vjeçar, me një mundësi të riemërimit sipas Ligjit për Punën. Ai/ajo raporton te Udhëheqësi i Shërbimeve të Përgjithshme i FKEE dhe tek Drejtori Menaxhues, varësisht nga natyra e çështjeve.

B) Roli dhe përgjegjësitë kryesore

Nën mbikëqyrjen e Drejtorit Menaxhues dhe Udhëheqësit të Shërbimeve të Përgjithshme, Zyrtari për Teknologji Informative është përgjegjës për ekzekutimin me cilësi të lartë dhe të koordinuar të detyrave / aktiviteteve të besuara atij / saj dhe shpërndarjen e rezultateve që kanë të bëjnë me këto detyra / aktivitete në kohë. Zyrtari për Teknologji Informative është përgjegjës për sigurinë, sistemet, komunikimet elektronike, përkthimin e njohurive dhe përvojave në fushën e Teknologjisë Informative në FKEE në përputhje me standardet, normat e vlefshme dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

C) Detyrat dhe funksionet specifike si dhe rezultatet e pritshme kryesore



FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

- Është përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë sistemeve të TI-së në FKEE dhe sigurinë e rrjetit dhe sistemit, përfshirë mbrojtjen nga rreziqet kibernetike (shërben edhe si zyrtar i sigurisë);
- Kujdeset për funksionin e të gjitha pajisjeve të teknologjisë informative për të krijuar një sistem funksional në përputhje me nevojat dhe kërkesat e FKEE-së;
- Bën instalimin, konfigurimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TI-se si: kompjuterë, lap-top, pajisje të rrjetit, printerë, skanerë, kamera të sigurisë etj.
- Ofron mbështetje teknike për të gjithë punëtorët e FKEE-së dhe përdoruesve të shërbimeve të FKEE-së
- Në baza ditore bënë ruajtjen e të dhënave për sistemet kryesore dhe informatat që janë me rëndësi për FKEE-në;
- Menaxhon dhe administron ueb faqen e FKEE -së dhe siguron qasje të lehtë dhe kualitative për vizitorët si dhe siguron që përmbajtja e ueb faqes të ruan shikueshmërinë.
- Shërben si mbikëqyrës i shërbimeve të kontraktuara të TI-se dhe pike kontakti për institucionet e Republikës së Kosovës dhe partneret e donatorët për fushën e TI-së Përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave të TI-së duke përfshirë edhe ato të sigurisë.

Ndër të tjera, është përgjegjës për:

- planifikim e ngritjes së kapaciteteve të TI-së në FKEE
- monitorimin e sistemeve të FKEE-së duke përfshirë edhe infrastrukturën e rrjetit.
- koordinimin e çdo investigimi të sigurisë në kuadër të TI-së dhe ekzekutimin e masave parandaluese duke përfshirë edhe dokumentimin e çdo shkeljeje/incidenti të sigurisë dhe vlerësimin e dëmit të tyre.

C) Kualifikimet, përvoja dhe aftësitë gjuhësore

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Diplomë Universitare – Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Teknologji Informative, ose ekuivalente (për kandidatët e diplomuar jashtë Kosovës, duhet të sigurohet prova e njohjes së diplomës në Kosovë);
- Përvojë punë profesionale 5 (pesë) vite nga të cilat të paktën tre (3) vite në detyra / aktivitete relevante, mundësisht si Zyrtar i Teknologjisë Informative;
- Njohuri të shkëlqyeshme për të paktën një nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe njohuri të mirë të gjuhës angleze;
- Trajnime në programe ndërkombëtare, ose/dhe puna me sisteme komplekse paraqitet si përparësi
- Nuk është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për një vepër penale për të cilën dënimi maksimal tejkalon gjashtë (6) muaj burgim dhe dënimi nuk është i kushtëzuar; (evidencat nuk duhet të jenë më të vjetra se data e shpalljes së vendeve të punës të këtij njoftimi për vendet e lira të punës).

D) Shpërblimi

Sistemi i pagave: Shpërblimi bëhet sipas pakos konkurruese në përputhje me Rregulloren e Brendshme për Shpërblimin e Personelit të FKEE (R-OBPSH).

F) Të dhëna tjera

FKEE nuk është organizatë buxhetore, marrëdhënia e punës themelohet sipas Ligjit të Punës.

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë / Kosovo Energy Efficiency Fund
Adresa: Luan Haradinaj p.n Ish-Banka e Lubjanës Kati 7, 10 000 Prishtinë – Republika e Kosovës
Address: Former Ljubljana Building, 7th floor, 10 000 Prishtina – Republic of Kosova
Tel: +383 (0) 38 223 777

Për më shumë detaje rreth FKEE: <https://fkee-rks.net/>

1. Përmbajtja e dokumenteve të aplikimit

Dokumentet e aplikimit duhet të përmbajnë së paku:

- 1) CV-në e hollësishme të aplikuesit
- 2) Letrën e motivimit përfshirë synimet e aplikuesit gjatë kohës së mandatit (jo më shumë se 3 (tri) faqe).
- 3) Kopje të diplomës (diplomave) për studimet e mbaruara universitare, përfshirë dëshminë e njohjes së diplomës (nëse aplikohet)
- 4) Kopje të dëshmisë se nuk ka qenë i dënuar (shiko kushtet e hollësishme në Seksionin C më lart)
- 5) Kopja e dokumentit përkatës që dëshmon shtetësinë.

Dokumentet e aplikimit mund të përgatiten në secilën prej tre (3) gjuhëve: shqip, serbisht ose anglisht. Kopjet e çfarëdo dëshmie që tregon për kualifikimet, përvojën dhe aftësitë gjuhësore të aplikuesve janë të mirëseardhura.

2. Dorëzimi i aplikacioneve

Aplikimet, përfshirë të gjitha dokumentet e kërkuara, dorëzohen në info@fkee-rks.net deri më **05 Dhjetor 2022, ora 16.00**.

Aplikacionet që nuk i kanë të gjitha dokumentet e parapara (1-5 më lart) nuk do të merren parasysh nga komisioni vlerësues.